

“Mjedisi Sot”
Nr 2189 E Premte 07/09/2007

Pergatitur nga Qendra Rajonale e Mjedisit

Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Kati III

Kutia postare 127, Tirane

Tel/Faks (+355 4) 23 29 28

Email: info@albania.rec.org

Web: <http://albania.rec.org>

www.mjedisisot.info

PERMBAJTJA

NGA VENDi

- Shkoder, bashkia “Iyp” vende per mbeturinat
- Ujerat e zeza permbytin “arkitekt sinanin”
- Banoret e sanxhakut rrezikohen nga kanali i ujerave te zeza
- Vlore, ambjentalistet: nuk lejojme ndertimin e tec-it
- Na ishte njehere ... Plazhi i patokut

NGA BOTA

- Akullnajat ne parkun montana dhe ndikimi i ndryshimeve klimaterike
- Ndryshojne hartat e botes
- Prodhuesit gjermane te makinave konfirmojne perdorimin e dioksidit te karbonit ne kondicionere

Njoftime

- Njoftim per vend te lire pune
- Konsultim publik mbi vleresimin e ndikimit ne mjedis te projektit “menaxhimi i integruar i ekosistemit te liqenit te shkodres”
- Thirrje per projekte ne kuadrin e programit te granteve te vogla

- Konusltime publike mbi planin strategjik te veprimit per llojet migratore
- Earthcorps International Program - International outreach trainer position announcement
- 11th international specialized conference on watershed & river basin management

Te gjitha OJF-te mjedisore dhe ato qe kryejne aktivite per mjedisin, jane te mirepritura te dergojne informacione ose njoftime, ne adresen 'Mjedisi Sot' info@albania.REC.org, ose Kutia Postare 127, Tirane.

Pergatitja e lajmeve ditore eshte mundesuar ne saje te mbeshtetjes nga Agjencia Spanjolle per Bashkepunim Nderkombetar – AECI.

Nga VENDI

SHKODER, Bashkia "Iyp" vende per mbeturinat
Brikena Shllaku, Gazeta Shqiptare, fq. 23

Mungesa e nje vendi per hedhjen e mbeturinave urbane te Shkodres vazhdon te jete nje nga problemet me te mprehta sociale per bashkine e ketij qyteti. Qe prej disa muajsh nuk ka mbetur qofte dhe nje meter vend per hedhjen e tyre. Te gjendur para nje situate te tille kritike me pasoja te renda ekologjike dhe mjedisore, bashkiaket kane filluar t'u "Iypin" komunave perreth vende per grumbullimin e plehrave te qytetit me mbi 100 mije banore. Por ne te shumten e rasteve, komunat nuk tregohen te ndjeshme ndaj ketij makthi, qe i ka vene "litarin ne fyt" Bashkise se Shkodres. Edhe ato pak vende te dhena "borxh" nga komunat e Gurit te Zi dhe te Kucit, tashme kane dale nga lista, pasi zonat e lejuara jane mbushur plot e perplot. Permasat ne rritje te ketij problemi te mbartur nder vite, ka detyruar kreret lokale qe te kerkojne ndihme urgjente per zgjidhjen e tij. Perfaqesues te Bashkise se Shkodres dje kane deklaruar per "Gazeta Shqiptare", se qeveria duhet te marre masa te menjehershme per sigurimin e fondit prej 1 milione eurosh, i cili do te beje te mundur ngritjen e landfillit ne komunen e Bushatit. Impiant ky qe do te perdoret jo vetem per perpunimin e mbeturinave urbane te qytetit te Shkodres, por dhe te Vaut te Dejes dhe te vete kesaj komune.

Mbeturinat urbane

E ndersa eshte premtuar me te madhe se shume shpejt do filloje puna per ngritjen e impiantit te perpunimit te mbeturinave urbane te qytetit te Shkodres, deri tani nuk eshte bere asgje per realizimin e ketij projekti ambicioz. Asnje donator nuk eshte treguar i gatshem qe te ndihmoje per ngritjen e landfillit ne fshatin Shkjeze te komunes se Bushatit. Behet fjale per nje investim, i cili vetem per fazen e pare arrin ne 1 milion euro. Ideja se kjo shume e madhe do te mund te sigurohej nga donatoret, tashme duket shume e larget. Rreth dy muaj me pare, perfaqesues te OSBE-se, te Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Territorit, perfaqesues te Cooperacione Italiane dhe drejtuesit lokale te Shkodres, realizuan nje takim pune per te sensibilizuar donatoret e ndryshem qe te kontribuojne per realizimin e projektit ne fjale. Pikerisht ne kete takim, zevendesministri Stavri Ristani deklaroi se ne vitin 2008, qeveria shqiptare do te parashikoje patjeter kete investim ne buxhetin e saj. Por Bashkia e Shkodres nuk ka luksin te prese miratimin e buxhetit te vitit 2008. Kjo, per faktin se nuk ka asnje meter vend per hedhjen e mbeturinave urbane. Prej disa kohesh, bashkiaket kane provuar te kerkojne "borxh" vende nga komunat perreth saj. Nderkaq, kryekomunaret nuk duan qe te japin sipërfaqe toke per hedhjen e mbeturinave te qytetit (sasia mesatare e tyre arrin ne 100 ton ne dite).

Bashkia

Te shqetesuar tejet nga mungesa e vendeve per grumbullimin e mbeturinave urbane te qytetit, Bashkia e Shkodres jep alarmin, duke kerkuar qe qeveria aktuale te marre masa per fillimin sa me shpejt te punes per ngritjen e landfillit ne komunen e Bushatit. Realizimi i projektit ne fjale do te

zgjidhte njehere e mire nje problem te mprehte social, i cili ka zene fill prej disa vitesh.

Ujerat e zeza permbytin "Arkitekt Sinanin"
Ermelinda Hoxhaj, Gazeta Shqiptare, fq. 13

Prej disa muajsh, banoret e rruges "Arkitekt Sinani" dhe "Stiki Cico" kane probleme me kanalizimet e ujerave te zeza. Sipas banoreve, gjendja e renduar eshte krijuar nga bllokimi i njerës prej pusetave kryesore ne kete zone. Edhe pse ata kane mbi nje muaj qe ankohen cdo dite prane Ujesjelles-Kanalizimeve dhe njesise bashkiake nr.3, askush nuk u ishte pergjigjur kerkesave te tyre. Por qe te merrnin fund hallet e tyre, eshte dashur qe te nderhynte drejtoria e shkolles 9-vjecare "Niket Dardani", ish-shkolla "23 nentori". Pasi vetem pas kerkesave te herepashershme qe ka ndermarre drejtoria e shkolles, eshte bere e mundur nderhyrja e specialisteve te bashkise se madhe dhe te Ujesjelles-Kanalizimeve. "Pas disa ankesave qe kemi bere per gati tre jave rresht, vetem sot kane ardhur specialistet e bashkise dhe te Ujesjelles-Kanalizimeve per te normalizuar gjendjen", - ka deklaruar per gazeten drejtoresha e shkolles 9-vjecare, Liri Shkemi. Sipas saj, eshte kerkuar nderhyrja e menjehershme e tyre, pasi ne 17 shtator nis shkolla dhe nuk mund te linin pusetat e ujerave te zeza ne ate gjendje, pasi jane rrezik epidemie per femijet, por dhe nje problem madhor per te gjithë zonen. Nderkohe, ditën e sotme pritet qe specialistet te nderhyjne dhe te cajne asfaltin per te zhbllokuar puseten.

Banoret e Sanxhakut rrezikohen nga kanali i ujerave te zeza
Gazeta Ballkan, fq. 8

Ne lagjen nr.5 Sanxhak, te qytetit te Lacit prej disa vitesh banoret jetojne ne gjendje katastrofike higjienike, ku nuk mund te jetojne edhe kafshet, por per fat te keq jetojne dhe njerezit. Kanali i madh i ujerave te zeza ka dale ne siperfaqe ne mes te lagjes, nderkohe qe mungon totalisht ndihma e shtetit. Ky kanal rrezikon te shkaktojë ndonje epidemi per te gjithë qytetin. Per kete problem, nje perfaqesi e deleguar nga banoret e Sanxhakut ka bere kerkese me goje e me letra, telegrame, filmime me kamera disa here, drejtuar kryeministrit, por dhe organeve te tjera kompetente. Pergjigja e ketyre organeve ka qene pozitive, por asnjehere nuk ka mberritur deri ne fazen e zbatimit, duke e lene gjendjen ne meshire te fatit. Kohet e fundit edhe kryeministri Berisha ka urdheruar te jepet mundesia per ndihme, por asnjeri nuk po merret me kete pune.

"Ne banoret e kesaj lagjeje nuk do te pushojme se ngrituri zerin derisa te zgjidhet problemi. Ne jemi te detyruar te perserisim kerkesat ne organet me te larta te shtetit dhe te shpresojme se qeveria do ta marre ne konsiderate kete problem qe luan me jeten e njerezve. Shpresojme qe dicka do te behet per lagjen tone Sanxhak", thuhet ne letren drejtuar redaksise se gazetes nga perfaqesia Sanxhak, Lac.

VLORE, AMBJENTALISTET: NUK LEJOJME NDERTIMIN E TEC-IT
Top Channel

Aleanca per Gjirin e Vlores ka kundërshtuar ashper vendimin e fundit te qeverise qe i jep Koorporates Elektroenergjitike Shqiptare te drejten e pronesise mbi nje siperfaqe prej rreth 13 hektarësh, ne te cilen do te ndertohet TEC-i i Vlores. Ky vendim qe eshte edhe procedura e fundit per fillimin e punimeve per ndertimin e TEC-it, me fuqi 100 mega, eshte cilesuar nga ambientalistet si krimi me i rende qe i eshte bere mjedisit ne Shqiperi. "Ai eshte territori i komunitetit vlonjate, i cili do te vazhdoje

te luftoje per ate vend duke e kthyer ne pelegrinazh. Nuk do te lejojme asnje TEC”, ka deklaruar kryetari i Aleances, Gani Mezini. Deklarata e tij eshte mbeshtetur nga anetarja Desdemona Stefa. “Vlora kerkon referendum. Dhe kjo do te mbahet mend si levizja e pare”, ka pohuar ajo. Ambjentalistet kane hedhur akuza edhe ndaj Bankes Boterore, duke e cilesuar ate si bashkautore ne kete projekt, qe sipas tyre nuk ka per qellim ndertimin e nje TEC-i te vetem. “Ketu do te ndertohen disa TEC-e, se ndryshe nuk ka perse t’i jepen KESH-it gjithe keto zona”, ka deklaruar ambjentalisti Adrian Klosi. Per ndertimin e TEC-it mendohet se do te priten rreth 30 mije pisha. KESH ka premtuar zevendesimin e tyre, por sipas ambjentalisteve, kjo eshte vetem nje genjeshter.

NA ISHTE NJEHERE ... PLAZHI I PATOKUT

Ardian Bushi, gazeta Koha Jone, fq. 19

Dikur nje prej plazheve me te frekuentuara, ku mijera banore te Kurbininit dhe zonave perreth kalonin pushimet, sot as qe munden te afrohen ne bregdetin e “virgjer” te Patokut. Panorama eshte tronditese dhe pushuesit e dikurshem, ende nostalgjike, pohojne se “e qajne me lot” mungesen e ketij plazhi. Thone se u mungon, por shtojne se ne gjendjen qe ndodhet, i druhen shume semundjeve, qe mund te marrin nga pisleku. Nje pjese e mire e bregdetit eshte kthyer ne varreze mbeturinash. Pa folur dhe per inerte te bunkereve te ndertuar para viteve ‘90-te. Pothuajse e gjithe zona eshte e ndotur. Grumbuj te medhenj hedhurinash kane kohe qe nuk po hiqen. Nga ana tjeter, cdo e keqe e paska nje te mire. Fauna ka pesuar nje rritje te ndjeshme. Peshkataret kane kohe qe peshkojne ne kete plazh, duke u kthyer ne nje burim te ardhurash per banoret e fshatrave perreth. Sikur te mos mjaftonin hedhurinat e papastertive te ketyre rretheve, mbeturinat e peshkut, te hedhura ne lumin Mat nga fabrikat e perpunimit te peshkut kontribuojne ne degjenerimin e nje prej plazheve me te frekuentuara ne vite, ne vendin tone. “Rera aq kurative dhe aq e preferueshme deri 12 vjet me pare, tashme eshte pushtuar nga papastertite, e ndihmuar kjo edhe nga bunkerizimi qe po i behet ketij plazhi nga ndertimet pa leje”, thote nje nga banoret vendas. Ata pak plazhiste, qe vazhdojne ta frekuentojne plazhin e Patokut, jane banoret e disa rrethinave. Pasojat e ndotjes se ketij plazhi jane shume te dukshme, ku pergjate vijes bregdetare gjen me shumice myshqe dhe shishe plastike. Dhe te vetmit, qe e frekuentojne kete plazh, tashme, jane banoret vendas. Ata pohojne se vijne ketu duke mos pasur mundesine ekonomike per te levizur nga Fushekuqja per ne Tale apo Shengjin...

NGA BOTA

Akullnajat ne Parkun Montana dhe ndikimi i ndryshimeve klimaterike

Parqet kombetare ne Shtetet e Bashkuara vleresohen per bukurine e tyre natyrale dhe gjallesat e egra. Ato jane ekosisteme delikate te cilat duan kujdes, dhe mbrohen per brezat e ardhshem. Duke patur parasysh natyren e tyre te brishte, shkancetaret kane nisur te shohin pasojat e ndryshimeve klimatike apo ngrohjes globale ne disa pjese te ketyre parqeve.

Qe ne fillim te shekullit te 20-te, Parku Kombetar Akullnajor i Montanes ka terhequr vizitore te shumte per bukurine e kreshtave dhe luginave te tij. Por vizitoret e sotem jane deshmitare te nje ndryshimi mjaft te shpejte te peisazhit.

Dan Fagre eshte ekolog ne agjencine amerikane Geological Survey, nje ent qeveritar qe merret me shkencen biologjike dhe token. “Shtresat akullnajore te Parkut Kombetar po zhduken me shpejtesi. Kryesisht ne keto dekadat e fundit. Keto blloqe akulli qe numeroheshin ne 150 kur parku u krijua

fillimisht, tani kane mbetur me pak se 27". Me teper se 7 mije vjet me pare, shtresa akulli prej 900 deri ne 1500 metra mbuluan kete vend. Masat e akullit mbulonin keto kreshta te valezuara dhe luginat rreth tyre.

Tani, Dan Fagre thote se akulli i mbetur po shkrin me nje ritem tejte te shpejte. Per kete ai fajeson ngrohjen globale. "Nje bllok akulli nuk mund te nxite ndryshimet klimatike. Por kur shihet qe fenomeni eshte i perhapur ne te gjitha akullnajat neper bote, kuptohet qe kemi te bejme me nje dukuri globale. Dhe ne kete rast, shkrija e akullnajeve po ndodh nga ngrohja". Fagre thote se nese shkrija e akujve vazhdon me keto ritme, atehere bloqet akullnaje do te zhduken brenda 20 vjetesh. "Pak sa nen re eshte lartesia akullnajeve Salamander. Shtresa e akullit qe e mbulon ate eshte e holle dhe prej saj rrjedh nje ujvare. Kjo akullnaje dikur bashkohej me bllokun e akullit Grinnell, i cili eshte shume me masiv se sa ai Salamander. Ky masiv ngrihej deri ne lartesine e burimeve te dy ujvarave. Ai ishte nje mije metra i larte kur u zbulua ne vitin 1887".

Kjo eshte zone ku rriten arinjtë e murrme. Te friksosh nje prej tyre eshte nje gabim me pasoja vdekjepruresë. Vizitoret qe ecin atyre aneve shpesh bejne zhurme per t'u dhene shenja arinjve se jane ne zonen e tyre. Sot, Parku Kombetar Akullnajeve eshte nje sistem ekologjik mjaft i pasur me nje mori bimesh dhe kafshesh te vecanta ne llojin e tyre. Por kjo mund te ndryshoje nese blloqet e akullit zhduken dhe klima e ftohte e dimrit zbutet. "Ndryshimet klimatike kane ndikim shume me te gjere se sa vetem tek akullnajat. Ato kane prekur edhe pyjet. Dhe ketu ju mund te shihni nje rrip te madh toke ku orteqet e bores kane skalitur hendeqe te medha ne pyje. Dhe ne keto hendeqe rriten bime apo organizma qe vlejne si ushqim per arinjtë apo zogjte, e per mjaft gjallesa te tjera qe nuk mund te gjejne ushqim ne pyje te dendur".

Burimi uhor qe ushqen ekosistemin e ketij mali po thahet, sic eshte thare dhe ky shtrat perroi. Disa prej ketyre liqeneve jane te pasur me nje lloj trofte qe jeton vetem ne ujjat e akullta te kesaj zone. Por edhe mjedisi i tyre eshte gjithashtu ne rrezik.

Shkencetaret thone se ndryshimet kane qene gjithnje pjese e jetes ne Toke dhe shume gjallesa u kane mbijetuar ndryshimeve te medha klimatike pergjate mijera viteve. Por Dan Fagre thote se tani gjndja eshte ndryshe. "Tani ne kemi parqe kombetare ne keto zona te mbrojtura qe po ndryshojne me shpejtesi ne te shumten e rasteve. Por gjallesat nuk kane ku te shkojne. Toka jashte ketij parku eshte perdorur nga njerezit per nevojat e tyre." Fagre beson se eventualisht toka do t'i pershtatet ndryshimeve klimatike. Por persa u perket parqeve kombetare ne Amerike, ato ndoshta do te mbijetojne, por peisazhi dhe gjallesat e tij nuk do te jene si me pare.

Per me shume informacion:

<http://www.voanews.com/albanian/2007-09-06-voa5.cfm>

NdryshojnE hartat e botEs
Gazeta Panorama

Efektet e ngrohjes globale jane te dukshme dhe kerkojne me domosdoshmeri paraqitjen e hartave te reja detare e tokesore te Tokes.

Keshtu besojne hartografet, te cilet i referohen Atlasit. Nje Atlas i ri bote do te publikohet me "Times 2007". Autoret e rinj jane te detyruar te ndryshojne linjen e brigjeve detare te shenuara me se fundi ne vitin 2003. "Mund te shikojme edhe me sy te lire nga lart shkaterrimin qe po ndodh. Kemi frike se ne nje te ardhme disavjecare disa vende do te zhdukjen fare nga harta pergjithmone", tha Nick Ashworth, nje nga studiuesit. "Kufijte e disa rajoneve ndryshojne. Per shembull Bangladeshi. Niveli i ujit eshte rritur me 3 milimetra ne vit qe gje ka ndikuar ne brigjet e tij. Ne Kine, lumi i verdhe nuk arrin me dot deri ne bregun e pervijuar dikur", shtoi ai. Ne Alaske avancimi i detit eshte disa metra ne vit. Ndersa

lumenjte "Rio i Madh" apo "Tigri" humbin cdo vit dege te tyre.

PRODHUESIT GJERMANE Te makinave konfirmojne perdorimiN E DIOKSIDIT TE KARBONIT NE KONDICIONERE
ENDS Europe DAILY 2381

Prodhuesit gjermane te makinave kane konfirmuar marrjne e nje vendimi per te perdorur dioksidin e karbonit si zevendesues i elementit HFC-134a te kondicioneret e makinave, te cilin Bashkimi Evropian do e nxjerre jashte perdorimit duke filluar nga viti 2011.

Si kunder reagim ndaj nje njoftimi te bere nga shoqata gjermane e industrise se automjeteve, Aleanca per zgjidhjet lidhur me dioksidin e karbonit shprehet se vendimi do te ushtroje presion mbi prodhuesit e makinave ne vendet e tjera te botes. Por nje zedhenes per industrine europiane te fluorkarbonit, e cila prodhon zevendesues alternative kimike per HFC-134a, shpreh sigurine se "disa prodhues makinash perseri do te zgjedhin fluorkarbonet".

Per me shume informacion:

<http://www.endseuropedaily.com/docs/70906a.pdf>

Njoftime

Njoftim PER VEND TE LIRE PUNE

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqiperi hap thirrjen per aplikime per vend te lire pune (me kohe te plote) ne pozicionin:

Asistent projekti - prane programit te Edukimit Mjedisor

Kuadri i punes:

- asistence ne organizimin dhe ndjekjen e aktiviteve qe do te zhvillohen ne kuader te programit te Edukimit Mjedisor
- asistence ne pergatitjen e materialeve te edukimit mjedisor ne kuader te programeve
- asistence drejtuesit te programit dhe te kordinatorëve te tjere ne ndjekjen e projekteve te tjera sipas nevojës

Pervoja dhe aftesite e kerkuara

- Shkollim i larte ne drejtimin mesuesi ose dege qe kane lidhje me te (p.sh. shkenca sociale, biologjike, te mjedisit)
 - Aftesi organizative te aktiviteve kualifikuese
 - Aftesi ne pergatitjen e materialeve te edukimit mjedisor
 - Njohje e mire gjuhes angleze (me shkrim dhe te folur)
 - Aftesi shume te mira te punes ne kompjuter (Word, Excel)
 - Aftesi per te punuar ne grup dhe gadishmeri per te udhetuar jashte rrethit ne perputhje me nevojat e programit
- Pervojat ne fushen e edukimit mjedisor, aftesite krijuese dhe aftesite ne fushen e design do te shihen me perparesi.

Dokumentet e nevojshme per aplikim:

- Leter interesi
- CV e shoqeruar me foton e aplikuesit dhe te dhenat e kontaktit (Tel. fiks/celular)
- Kopje e diplomes se shkolles se larte
- Certifikata te ndryshme kualifikimi (nese zoteron)

Dorezimi i aplikimeve: Date 14 Shtator 2007, ora 17.00: prane:

Daniela Tola
Qendra Rajonale e Mjedisit
Shqiperi
Rr. Ismail Qemali, Nr. 27 (Pallati i Fratarit)
Kutia Postare 127, Tirane
Tel/fax: (04) 232928
E-mail: daniela@albania.rec.org
Web: <http://albania.rec.org>

Shenim: Do te njoftohen vetem aplikantet e sukseshem te perzgjedhur per interviste.

Konsultim publik mbi vleresimin e ndikimit ne mjedis te projektit “menaxhimi i integruar i ekosistemit te liqenit te shkodres”

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, permes Njesise se Menaxhimit te Projektit “Menaxhimi i Integruar i Ekosistemit te Liqenit te Shkodres” ne kuader te hartimit perfundimtar te ketij Projekti, kerkon mendimin e institucioneve, publikut te interesuar dhe te Organizatave Jofitimpruese mjedisore per studimin mbi Kornizen e Projektit.

Studimin ne gjuhen Shqipe dhe Angleze mund ta gjeni ne adresen e meposhtme:

Njesia e Menaxhimit te Projektit «Menaxhimi i Integruar i Ekosistemit te Liqenit te Shkodres»

Godina e Prefektures Shkoder

Kati i Dyte

Jeni te lutur per komente dhe sygjerime, te cilat mund te dergohen brenda dates 10 Shtator 2007 ne adresen e mesiperme ose ne adresen e emailit: a_shimaj@yahoo.com

Thirrje per projekte ne kuadrin e programit te granteve te vogla
LAJMERIM I FONDACIONIT SOROS

Programi i Granteve te Vogla prane Fondacionit Soros mundeson zhvillimin e bashkepunimit ndermjet grupeve te ndryshme te komunitetit, nxit dhe promovon dialogun per probleme te ndryshme qe shqetesojne shoqerine shqiptare, ofron mbeshtetje per fuqizimin e grupeve vulnerable, vecanerisht grave dhe femijeve; ndihmon ne permiresimin e gjendjes se minoriteteve, me perparesi komunitetin Rom, etj.

Kjo thirrje synon te mbledhe propozime per projekte ne drejtimet e meposhtme:

Permiresimi i gjendjes se komuniteteve, vecanerisht te shtresave vulnerabel dhe te margjinalizuarve, si dhe te minoriteteve etnike e kulturore me perparesi minoritetin Rom;

Fuqizimi i komuniteteve te grave dhe te rinjve per te rritur pjesemarrjen ne qeverisje dhe ne jeten ekonomike dhe sociale te vendit;

Monitorim i praktikave te qeverisjes dhe gjallerim i debatit publik per probleme sociale qe interesojne qytetaret;

Rritja e aksesit te qytetareve ne informacionin e institucioneve publike;

Ne kete program jane te ftuar te aplikojne organizata jo-qeveritare qe punojne me komunitetin, grupe pune dhe institucione/organizma qe kane per mision punen me keto grupe/shtresa te shoqerise. Shuma e financuar do te jete deri ne 7500\$. Ky informacion si dhe formulari i aplikimit (se bashku me listen e dokumentave shoqeruese) jane vendosur edhe ne faqen e internetit: www.soros.al.

Te interesuarit mund ta marrin formularin e aplikimit on-line, apo te paraqiten prane sekretarise se Fondacionit Soros.

Forma e aplikimit dhe dokumentat e tjera te nevojshme duhet te dorezohen prane Zyres se OSFA ne adrese te Programit te Granteve te Vogla deri me 10 shtator 2007 brenda ores 15:00 ne adresen e meposhtme. Se bashku me dokumentacionin shkresor duhet te dorezohet edhe nje kopje elektronike e projektit (me e-mail ne adresen bskendo@osfa.soros.al, diskete apo USB/CD). Aplikimet me mangesi ne dokumentacion dhe ato qe nuk do te paraqiten ne formen e kerkuar do te skualifikohen automatikisht.

Fondacioni Shoqeria e Hapur per Shqiperine

(Fondacioni Soros)

Rruga "Pjeter Bogdani", Nr.23

Tel:34621/34223/35856

Fax: 35855

KONSULTIME PUBLIKE MBI Planin Strategjik te veprimit PER LLOJET MIGRATORE

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, ne kuader te detyrimeve qe rrjedhin nga ratifikimi i Marreveshjes Afrikane-Euroaziatike per Ruajtjen e Shpendeve te Ujit (AEWA) – nje marreveshje ne kuadrin e Konventes se Bonit “Per llojet migratore” (CMS), kerkon mendimin e publikut te interesuar dhe te Organizatave Jofitimruese mjedisore per Planin Strategjik te veprimit 2009-2017, i cili eshte derguar per mendim nga Sekretariati i Marreveshjes.

Jeni te lutur per komente dhe sygjerime, te cilat mund te dergohen brenda dates 14 Shtator 2007 ne adrese te Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave – Drejtoria e Politikave te Mbrojtjes se Natyres - Zamir DEDEJ zdedej@moe.gov.al

Draft Strategjine e plote mund ta gjeni ne faqen e REC Shqiperi, ne rubriken Njoftime: <http://albania.rec.org/AplikimeNjoftime.html>

EarthCorps International Program - International Outreach Trainee Position Announcement

Position description

The International Outreach Trainee position is a training level, seasonal position in EarthCorps. EarthCorps provides environmental restoration training to emerging leaders, along with leadership training, community service and multicultural understanding of local and global issues. The Outreach Trainee's two primary responsibilities are to facilitate field projects for community and agency partners

within the EarthCorps Outreach division and to gather and develop materials to start or support an environmental outreach program in his/her home country. This position reports to the Outreach Program Manager.

Duties and responsibilities

Professional Networking and Workshops:

- Participates in structured series of field, workshop, and classroom trainings. Training will focus on ecological restoration and stewardship, environmental education and youth leadership development.

Youth and Community Outreach Projects:

- Community events at various sites in the Seattle area & special Earth Month events in April.

International Project:

- Writes Individual project proposal in conjunction with sponsored NGO.
- Researches and carries out fundraising opportunities to support project.

Program Support & Administrative:

- Assists other EarthCorps programs/staff as assigned.
- Attends all required staff meetings.
- Completes necessary paperwork in a timely manner. (Training logs, timesheets, etc).
- Prepares oral and written reports of training projects, equipment use and maintenance, project reports and incident reports.

Project Implementation:

- Develops and implements outreach programming and field projects in conjunction with field staff, as well as with community and government agencies.
- Facilitates restoration-based service-learning programs.
- Trains volunteers in environmental restoration techniques.

Training Supervision:

- Maintains appropriate standards of behavior, policies and procedures of EarthCorps.
- Provides leadership and direction in support of program goals and mission.
- Assists in counseling, motivation and discipline of individual program participants.

Communication:

Supports efforts of EarthCorps.

Promotes the health and well being of EarthCorps, staff and corpsmembers in all communications.

Resolves issues/concerns directly with EC staff/corps members or that person's supervisor.

Outreach trainee's terms of service

Status: Volunteer, temporary

Period of training: mid January, - mid December, 2008

Stipend: \$360 / month

Hours of training: 7:30 am – 5:00 pm Mon-Fri; approx. every other Friday off

3-4 multi-day program retreats outside of Seattle throughout program

Possible camping for 2-3 weeks of program

Benefits:

Travel Insurance premium paid for volunteer only.

Bus passes provided during term of service
Airfare to and from Seattle may be partially paid by EarthCorps
Homestay family in Seattle (provides a private bedroom and meals)
Boots, pant, T-shirt and rain gear provided

Required qualifications

5 years practical experience in the environmental field

-Or-

4 years post secondary education, plus one year of work experience in a field related to the environment.

- Interest in environmental fieldwork, intercultural knowledge and educational activities
- Commitment to teamwork with peers from around the world
- Desire to engage in service learning
- Support from a sponsoring organization
- Conversational English
- No Criminal Record

To apply

Candidates should be referred to EarthCorps by an environmental organization (i.e. NGO, LGU, community group or student club).

Materials are available online at: http://www.earthcorps.org/join_international.php.

Application materials will be sent for the candidate upon confirmation of the referring organization. Referring organizations should have completed the Partner Application Form and send the Candidate Nomination to: mark@earthcorps.org

Deadlines and start dates:

- Application Deadline: September 21, 2007
- Participant selection: October 2007
- Visa processing: October 2007 - December 2007
- Travel confirmation: January 4, 2008
- EarthCorps Program starting date: mid-January 2008
- EarthCorps Program graduation: mid-December 2008

11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management

The International Water Association is going to organize 11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management on 4-5 September 2008 in Budapest.

The Call for Papers in electronic form (CfPe) which gives a summary of the most important information about the conference can be found on: www.iwa2008budapest.org

Water is a challenge for the century.

Exploring the sustainability of our most valuable resource is our business. IWA presents a unique opportunity to engage in 2 days of innovative discussion on the subjects of Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls and Monitoring and Modelling.

Join other experts in exchanging ideas and exploring networking opportunities during the IWA Watershed and River Basin Management Conference, 4-5 September 2008 in beautiful Budapest, Hungary. Mark this event on your calendar and begin to plan abstract / paper / poster today.

Topics of the Conference:

Include but are not limited to Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls, Monitoring and Modelling.

- River basin management planning under the EU Water Framework Directive;
- River basin management practices in different continents;
- Managing water resources in transboundary river basins with conflicting demand;
- Managing competing uses to protect water quality and quantity;
- Watershed management methods to facilitate water availability for aquatic ecosystem health and human uses;
- Interconnecting sub-watersheds to achieve basin goals;
- Hierarchical approaches to river basin management.
- Monitoring, ecological classification in EU countries and intercalibration;
- State-of-the-art in assessing water and biological quality and integrating data.;
- Programme of measures and ecological state.
- River basin management, advanced computation and decision support;
- The impact of climate change on watersheds, river basins, estuaries and reservoirs;
- Flood control and prevention.
- Effective methods to involve stakeholders and the public into the river basin management planning processes;
- Conflicts and multi-objective management – is it mostly methodology?
- Economics of River Basin Management.

The internet site of the conference is already open (www.iwa2008budapest.org) and interested candidates could submit abstracts under the Registration menu.

The abstract submission period is open until the end of September 2007.

C'eshte "Mjedisi Sot"

"Mjedisi Sot" eshte nje nga botimet periodike te Qendres Rajonale te Mjedisit - Zyra ne Shqiperi. Ne kete botim ditore do te gjeni lajme dhe probleme mjedisore nga shtypi i dites, informacion per aktivitetet mjedisore nga vendi dhe bota.

Per t'u futur falas ne listen e shperndarjes se "Mjedisi Sot" ose per t'u cregjistruar, dergoni nje e-mail ne adresen: info@albania.REC.org

Versionin e shtypur mujor te "Mjedisi Sot" mund ta gjeni prane Zyres se REC ne Shqiperi.

Lajmet mjedisore ditore dhe "Mjedisi Sot" mujor mund t'i gjeni edhe ne internet: <http://albania.REC.org>

www.mjedisot.info

C'eshte REC

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) per Evropen Qendrore e Lindore eshte nje organizate nderkombetare jopartizane, joavokate, jofitimpruese qe mbeshtet zgjidhjen e problemeve mjedisore ne Evropen Qendrore e Lindore (EQL), duke nxitur bashkepunimin ndermjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktoreve te tjere mjedisore, si dhe duke mbeshtetur shkembimin e lire te informacionit dhe pjesemarrjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore.

REC eshte krijuar ne 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot REC, bazohet ligjerisht ne Karten e tij, nenshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian, dhe ne nje marreveshje nderkombetare me qeverine hungareze. REC ka zyren qendrore ne Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve ne secilin prej 16 vendeve perfituese. Shqiperia e ka nenshkruar Karten e REC ne 1992. Zyra e REC per Shqiperine eshte hapur ne 1994. Kjo zyre punon per realizimin e misionit te REC duke mbeshtetur organizatat jofitimpruese, institucionet mjedisore ne te gjitha nivelet, dhe aktore te tjere te interesuar ne fushen e mjedisit, duke mbeshtetur proceset pjesemarrrese dhe shkembimin e lire te informacionit. Fushat kryesore te veprimtarise jane: Programi i granteve per OJF-te; Planet Lokale te Veprimit ne Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit per OJF-te dhe zyrtare te mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj.

Nese jeni te interesuar te njiheni me cfare ndodh cdo dite ne mjedisin shqiptar dhe neper bote, abonohuni falas ne "Mjedisi Sot", pakete e perditshme elektronike. Dergoni nje mesazh me titull "Abonim" tek info@albania.rec.org
